



Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Albanian National Olympic Committee

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: sekretariat@nocalbania.org.al • <http://www.nocalbania.org.al>

NJOFTIM PËR POZICIONIN

MARRREDHENIE ME PUBLIKUN / GAZETAR/E

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH) është një organizatë sportive Kombëtare e pavarur, themeluar në vitin 1958, pa qëllim fitimi, e organizuar mbi bazën e parimeve të Kartës Olimpike, dhe që funksionon sipas statutit të saj. KOKSH është organizata e vetme që përfaqëson Lëvizjen Olimpik Shqiptare, parimet e së cilës janë të detyrueshme për tu zbatuar nga të gjithë anëtarët e saj.

Në kuadër të Projektit “**Ekipet Sportive 2022**”, projekt i financuar nga Buxheti i Shtetit, KOKSH, fton kondidatët e interesuar për të aplikuar për pozicionin e punës “**Marrëdhënie me Publikun / Gazetar/e**”.

Objektivi i përgjithshëm i Projektit është krijimi i një Programi Kombëtar që nxit 1) sportin masiv, 2) zbulimin e talenteve, 3) edukatën sportive dhe parimet olimpike. Projekti do të formojë Ekipet sportive jashtë shkollore në nivelin 9-vjecar (nga klasa e 6 – 9); në nivelin shkollë e mesme (nga klasa 10 – 12); në universitete.

Detyrat e Marrëdhënie me Publikun / Gazetar/e

Jemi në kërkim të një personi të kualifikuar për t'iu bashkuar stafit të projektit “Ekipet Sportive 2022”. Përpos të qenit një gazetar shumë i mirë, aplikanti i suksesshëm duhet të demonstrojë interesin e tij/saj për sportin. Objektivi kryesor i pozicionit do të jetë komunikimi me palë të treta apo publikun në emër të projektit, si dhe krijimi i kontetit për të komunikuar në emër të projektit, duke përfshirë krijimin e lajmeve për projektin. Ky person do të përfshihet në cdo detyrë të nevojshme për ecurinë normale të punës apo të caktuar nga supervizori. Duhet të jeni miqësorë, të vetë-motivuar dhe të keni aftësi të jashtëzakonshme komunikimi me shkrim dhe verbal.



Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Albanian National Olympic Committee

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63
Tel: +355 4 2235 249 • E-mail: sekretariat@nocalbania.org.al • <http://www.nocalbania.org.al>

Për të përmbushur objektivat e caktuara ky person duhet të ketë:

Kualifikimet dhe Eksperienca:

- Të ketë minimumi një diplomë Bachelor në Gazetari dhe Shkenca Komunikimi.
- Eksperiencë pune minimum 5 vjet.
- Të ketë experiencë të mëparshme si gazetar/e.
- Preferohet të ketë punuar në 3 vitet e fundit në media.
- Të ketë njohuri shume të mira të gjuhës Angleze.

Aftësi dhe kompetenca kryesore

- Aftësi ndërpersonale, komunikim profesional verbal dhe të shkruar.
- Aftësi shumë të mira të folurit në publik dhe live në transmetime televizive.
- Aftësi bashkëpunimi dhe ndërveprimi në ekip dhe me drejtuesit.
- Qasje pozitive dhe energjike në punë.
- Orientim ndaj detajeve dhe organizimit të proceseve të punës.

Procedura e aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentat e aplikimit si më poshtë:

- Curriculum vitae (CV) në formatin Europass;
- Letër Interesi;
- Fotokopje të diplomave universitare;
- Dokumente të tjera mbështetëse (çertifikata të fituara nga trajnime, pjesëmarrje në konferenca, botime, letra reference, etj).

Kandidatët e interesuar duhet t'i dërgojnë dokumentet e aplikimit deri më datë 12 Maj 2022, ora 16.00, në adresën secretary.general@nocalbania.org.al, me subjekt: **Aplikim për pozicionin Marrëdhënie me Publikun / Gazetar/e "Ekipet Sportive 2022"**

